


Pranuar më : 05.09.2019

Pranuar



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Avokatura Shtetërore - Državno Pravobranilaštvo – State Advocacy Office

A.nr.1822/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

2019 JUN 17 AM 11:26

GJYKATA THEMELORE
OSNOVNI SUD
PRISHTINE-PRISTINA
PRANUAR PRILUJENO

PADITËS: Blerta Morina nga [REDACTED] - KK Gjakovë,

E PADITUR: Ministria e Punëve të Brendshme - Agjencia për Regjistrim Civil.

E paditura në afatin ligjor të paraparë me nenin 37 (2) të Ligjit për Konfliktet Administrative, bënë këtë:

PËRGJIGJE NË PADI

Paditësi me padi ka kërkuar që të aprovohet ankesa - padia e tij si dhe të anulohet Vendimi i të paditurës, më gjërësisht si në kërkesëpadi.

E paditura e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

E paditura MPB/ARC për Gjykatën sqaron se Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave kundër vendimeve të Zyreve të Gjendjes Civile e ka shqyrtuar ankesën e Blerta Morinës me dt.13.06.2018 lidhur me kërkesën për ndërrimin e emrit personal nga Blerta Morina, në Blert Morina dhe ndërrimin e gjinisë nga femër, në mashkull në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile.

Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha provat dhe dëshmitë që i ka ofruar znj.Blerta Morina në kërkesën e saj drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë si në vijim: kërkesën nr.02 e dt.04.04.2018 për ndërrimin e emrit personal, ku e ka cekur arsyen e ndërrimit të emrit personal për shkak se emri i saj aktual, po e pengon personin në integrimin e tij në shoqëri dhe ndërrimin e gjinisë nga femër në mashkull, kopjen e letërnjoftimit të saj me numër [REDACTED]. Ekstratin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. [REDACTED] certifikatën e lindjes me [REDACTED] vërtetimin nga Arkivi nr. [REDACTED] vërtetimin nga Policia e Kosovës me nr.867 i datës 06.04.2018, certifikatën nga Gjykata Themelore në Gjakovë me nr.2508/2018 i datës 03.04.2018, vërtetimin

tatimor nga ATK të datës 29.03.2018, Rekomandimin nga Komisioni për verifikimin e kërkesave për ndërrimin e emrit personal me nr.1429/2018 i datës 25.04.2018 i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Komisioni me rastin e vendosjes është bazuar në nenin 11 dhe 32 të Ligjit Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile si dhe nenin 12 të Ligjit për Emrin Personal Nr.02/L-118 si dhe Udhëzimin Administrativ MPB Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat për Ndërrimin dhe Korrigjimin e Emrit Personal.

Komisioni konstaton se vendimi i Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë me Nr.02-201-02-8319 i datës 26.04.2018 lidhur me kërkesën për ndërrimin e emrit personal nga Blerta Morina, në Blert Morina dhe ndërrimin e gjinisë nga femër, në mashkull në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile është nxjerrë në përputhje me aktet ligjore të përmendura më lartë dhe se kërkesa e znj.Blerta Morina, nuk gjen mbështetje për të vërtetuar të drejtën në ndërrimin e emrit personal sipas arsyes së cekur në kërkesën e saj më saktësisht se e njehta dëshiron të ndërroj emrin personal me arsyetimin se emri personal aktual po e pengon personin në integrimin e saj në shoqëri.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet dhe shkresat tjera në lëndën dhe ka konstatuar se arsyeja se dëshiron që ta ndërroj emrin personal për shkak se ky emër personal aktual po e pengon personin në integrimin e saj në shoqëri nuk qëndron sepse personi nuk ka dhënë asnjë dëshmi që tregon se emri personal Blerta Morina po e pengon personin në integrimin e saj në shoqëri.

Po ashtu Komisioni me rastin e shqyrtimit të ankesës është bazuar në nenin 11 dhe 32 të Ligjit Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile meqë pala ka kërkuar edhe ndryshimin e gjinisë si fakt natyre, prandaj Komisioni bazuar në nenin 11 të këtij Ligji, ku thuhet që lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja, vërtetohen rregullisht si fakte juridike, nga personat dhe organet të cilëve ju njihet kjo e drejtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe neni 32 që thotë që lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i aeroplanit në udhëtim, drejtuesi i burgut, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor nënkuptohet që ligjërisht kërkesa e znj.Blerta Morina nuk është e bazuar sepse sipas ligjit nënkuptohet që vërtetimi i gjinisë dhe eventualisht ndërrimi apo korrigjimi i këtij përbërësi të gjendjes civile bëhet vetëm me një raport apo vendim mjekësor.

PROVË:

- Kërkesën nr.02 e datës 04.04.2018 për ndërrimin e emrit personal ku e ka cekur se arsyeja e ndërrimit të emrit personal është për shkak se emri i saj aktual po e pengon personin në integrimin e tij në shoqëri dhe ndërrimin e gjinisë nga femër në mashkull
- Kopjen e letërnjoftimit të saj me nr. [REDAKTUAR]
- Ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. [REDAKTUAR]
- Certifikatën e lindjes me nr. [REDAKTUAR]
- Vërtetim nga Arkivi nr. [REDAKTUAR]

- Vërtetimi nga Policia e Kosovës me nr.867 i datës 06.04.2018
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Gjakovë me nr.2508/2018 i dt.03.04.2018
- Vërtetimi tatimor nga ATK i dt.29.03.2018
- Rekomandimi nga Komisioni për verifikimin e kërkesave për ndërrimin e emrit
- Vendimi i Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë me nr.02-201-02-8319
- Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave kundër Vendimeve të Zyrave të Gjendjes Civile me nr.64/04 të dt.13.06.2018

Duke pasur parasysh thëniet e cekura më lartë, faktet dhe provat e paraqitura si dhe dispozitat ligjore të cituara, përfaqësuesja e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Agjencia për Regjistrim Civil, i propozon Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, që pas administrimit të provave të bashkangjitura të marr:

AKTGJYKIM

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Blerta Morina nga [REDACTED] KK Gjakovë, në tërësi si e **PABAZUAR**.

MBETET në fuqi Vendimi Nr.64/04 të dt.13.06.2018 i Ministrisë së Punëve të Brendshme - Agjencia për Regjistrim Civil.

Më datë 17.06.2019
PRISHTINË

AVOKATËRA SHITETËRORE E KOSOVËS
AVOKAT SHITETËROR
Naime Abazi

Naime Abazi